

## MENDIM PARALEL

Unë, Genta Tafa (Bungo), në cilësinë e relatores së trupit gjykues, që ka kryer procesin e rivlerësimit kalimtar pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit Avni Sejdi, kam votuar për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të tij, sikundër dy anëtarët e tjerë, por, në dallim nga vendimmarrja përfundimtare e shumicës, kam vlerësuar se disa konkluzione në lidhje me kriterin e pasurisë, së bashku me konkluzionet në kriterin e vlerësimit profesional, të marra së bashku, janë të mjaftueshme për të aplikuar edhe nenin 61/5 të ligjit nr. 84/2016.

Duke mos qenë dakord me një pjesë të qëndrimit të mbajtur nga anëtarët e tjerë të trupit gjykues, që ka çuar në disa konkluzione që nuk më gjejnë dakord, në vijim po pasqyroj mendimin tim paralel/ndryshe nga arsyetimi i vendimit të Komisionit.

### **Në lidhje me vlerësimin e pasurisë**

Në tërësi bashkohem me vendimmarrjen e shumicës, por, gjithashtu, mendoj se disa konkluzione të nxjerra në këtë vlerësim duhet të merren në konsideratë në vlerësimin tërësor të procedurave, më konkretisht:

1. Subjekti gjatë hetimit, por edhe pas kalimit të barrës së provës, ka tentuar të paraqesë në mënyrë të pasaktë:
  - i. kohën e pagesës së apartamentit;
  - ii. kohën dhe mënyrën e përfitimit të shumave të dhuruara nga vëllezërit e tij, si dhe ka refuzuar të paraqesë nxjerrjen e llogarive bankare të vëllezërve të tij;
  - iii. marrëdhënien e huas me shtetasin Armand Rraja.
2. Në lidhje me vlerën e shitjes dhe blerjes së automjetit me targë LA \*\*\* A, mendoj se nuk është e rëndësishme të vlerësohet thjesht dhe vetëm diferenca çmim shitjeje/blerjeje, por e gjithë sjellja në tërësi.
  - i. Subjekti e ka blerë këtë automjet në një vlerë më të ulët se çmimi i blerjes, pasi ai është blerë nga shitësi në shumën 313,898 lekë (përfshirë edhe shpenzimet doganore) dhe është shitur tek subjekti në shumën 250,000 lekë.
  - ii. Subjekti nuk ka vënë në dispozicion të Komisionit dokumentacion për gjendjen e automjetit në kohën e blerjes, për të provuar në këtë mënyrë pretendimet e tij se ka kryer shpenzime për riparimin e tij.
  - iii. Deklarimi i shpenzimeve në vlerën 50,000 lekë, pas kalimit të barrës së provës, nuk justifikon çmimin 250,000 lekë për blerjen e këtij automjeti, pasi vlera e blerjes nga shitësi sërish është më e lartë.
  - iv. Subjekti e ka shitur këtë automjet pas 4 vjetësh përdorimi, në një vlerë rreth 1.6 herë më të lartë se çmimi i blerjes.

Nga të gjitha këto fakte, në mungesë të një dokumenti provues të shpenzimeve të kryera për rritjen e vlerës së automjetit pas 4 vjetësh përdorimi, vlerësoj se mungon logjika ekonomike apo tregtare e rritjes së vlerës së kësaj pasurie. Për rrjedhojë, subjekti nuk i ka rrëzuar dyshimet për një vlerë fiktive të çmimit të shitjes dhe blerjes së këtij automjeti, me qëllim justifikimin e shpenzimeve të kryera.

3. Komisioni ka konstatuar në më shumë se një rast cenim të etikës së magjistratit nga ana e subjektit, më konkretisht:

- i. Veprimet e subjektit në lidhje me automjetin tip “M-B”<sup>1</sup> janë konsideruar se nuk përputhen me etikën dhe sjelljen e duhur për një gjyqtar, detyrim që rrjedh nga parashikimet ligjore të nenit 23 të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008, si dhe rregullit 15 të Kodit të Etikës Gjyqësore, miratuar në datën 8.12.2006.
- ii. Subjekti ka kryer veprime fiktive me shtetasin A.Rr, veprime të cilat janë konsideruar se nuk përputhen me etikën e magjistratit.
- iii. Në lidhje me konfliktin e interesit me z. F, Komisioni ka vlerësuar se duke marrë në konsideratë faktin se: (a) çështjet në qytetin e Pukës nuk kanë qenë të shumta; (b) vlerën e vogël të huas, si dhe bazuar në deklaratimet e subjektit se në qytetin e Pukës kanë qenë vetëm dy avokatë – ky konflikt i interesit të konsiderohet si cenim i etikës. Në këtë çështje vlen të mbahet në konsideratë përshkrimi i veprimit në bankë “Paga prill 2010”, përshkrim ky që mbeti i pashpjeguar nga subjekti edhe gjatë seancës dëgjimore.

### **Në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale**

Në këtë pikë bashkohem me shumicën se ato nuk janë të mjaftueshme për të konsideruar subjektin si të paaftë, por ndërkohë mendoj se mangësitë e konstatuara duhet të merren në konsideratë në vlerësimin tërësor të procedurave, më konkretisht:

1. Ndryshe nga shumica, në rastin e ankesës së shtetasit J.M, vlerësoj se në lidhje me sjelljen e subjektit nuk jemi para një rasti të izoluar, pasi ai në më shumë se një rast ka kryer veprime që cenojnë etikën e gjyqtarit. Parë në këtë këndvështrim, kam çmuar që kjo sjellje, së bashku me konstatimet e tjera të cituara në këtë mendim paralel, duhet të merreshin në konsideratë në vlerësimin tërësor të procedurave. Shkeljet e subjektit edhe nga KLD-ja janë konstatuar si akte dhe sjellje të tjera të rënda, që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit, por duke qenë se ishte një rast i izoluar, janë mjaftuar me dhënien e masës së tërheqjes së vëmendjes.
2. Komisioni në disa raste në vlerësimin profesional ka konstatuar mangësi profesionale, si vijon:
  - i. Shtetaset M.S dhe S.G

Komisioni në lidhje me këtë denoncim ka vlerësuar se subjekti ka demonstruar mangësi në aspektin e njohurive ligjore në kuptim të nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, si dhe në aspektin e arsytimit ligjor në kuptim të nenit 72/3 të ligjit nr. 96/2016 në lidhje me cilësinë e analizës dhe argumentimit të vendimit, si dhe ka cenuar të drejtën e pronësisë së palëve të paditura, duke vendosur çregjistrimin e pasurisë në emër të tyre, pa analizuar vlefshmërinë e akteve nëpërmjet të cilave ishte përfituar kjo pasuri.

- ii. Shtetasi B.H

Në përfundim, në lidhje me këtë denoncim, Komisioni ka vlerësuar se subjekti ka demonstruar mangësi në aspektin e arsytimit ligjor në kuptim të nenit 72/3 të ligjit nr. 96/2016 në lidhje me cilësinë e analizës dhe argumentimit të vendimit.

- iii. Shtetasja R.C

Në lidhje me këtë denoncim, Komisioni në përfundim ka vlerësuar se subjekti ka demonstruar mangësi në aspektin e arsytimit ligjor në kuptim të nenit 72/3 të ligjit nr. 96/2016 për cilësinë e analizës dhe argumentimit të vendimit, si dhe mangësi në aspektin e njohurive ligjore në kuptim të nenit 72/2 të ligjit nr. 96/2016 në lidhje me ndërgjyqësinë.

- iv. Shtetasi A.D

---

<sup>1</sup> Shihni për më shumë pika 119-120 të vendimit.

- v. Në lidhje me këtë denoncim, Komisioni ka konstatuar se subjekti nuk ka dhënë asnjë shpjegim se cili ka qenë akti që duhej të regjistronte ZVRPP-ja sipas përcaktimeve të nenit 38 të ligjit nr. 33/2012. Gjithashtu, ai nuk ka dhënë asnjë argument në lidhje me gjënë e gjykuar apo me faktin se vendimi i INV-së është anuluar nga ana e gjykatave. Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se subjekti ka demonstruar mangësi në aspektin e arsytimit ligjor në kuptim të nenit 72/3 të ligjit nr. 96/2016 për cilësinë e analizës dhe argumentimit të vendimit dhe në aspektin e njohurive ligjore në kuptim të nenit 72/2 të ligjit nr. 96/2016.

### **Në përfundim,**

Në vlerësimin tërësor të procedurave lidhur me cenimin e besimit të publikut, duke vlerësuar në tërësi kriterin e pasurisë dhe atë profesional për subjektin e rivlerësimit, në kuptim të nenit 4, paragrafi 2 i ligjit nr. 84/2016, rezultojnë disa rrethana, të cilat, të analizuara së bashku e të para në harmoni me njëra-tjetrën, tregojnë për një sjellje të subjektit të rivlerësimit në raport me detyrën, e cila do të ishte e papranueshme për të pasur besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe te roli i subjektit si një funksionar i denjë i atij sistemi.

Në këto rrethana përfshihen problematikat e konstatuara në drejtim të kontrollit të kriterit të pasurisë, si dhe atij profesional:

- i. deklarimet e pasakta për kohën e pagesës së çmimit të apartamentit, të përfitimit të shumave të dhuruara nga vëllezërit, si dhe të marrëdhënies së huas me shtetasin A.Rr, të cilat të gjitha së bashku kanë tentuar të prodhojnë një rezultat në favor të subjektit;
- ii. dyshimet për një vlerë fiktive të çmimit të shitjes dhe blerjes së automjetit me targë LA \*\*\* A, me qëllim justifikimin e shpenzimeve të kryera;
- iii. cenimin e etikës së magjistratit në lidhje me: (a) veprimet e subjektit me automjetin tip “M-B”; (b) veprimet fiktive me shtetasin A.Rr; (c) gjendjen e konfliktit të interesit me shtetasin A.F;
- iv. cenimi i etikës së magjistratit për shkak të sjelljes jashtëgjyqësore me shtetasin J.M;
- v. mangësi të përsëritura në aspektin e njohurive ligjore në kuptim të nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, si dhe në aspektin e arsytimit ligjor në kuptim të nenit 72/3 të ligjit nr. 96/2016 në lidhje me cilësinë e analizës dhe argumentimit të vendimit, si dhe cenimi i të drejtave të palëve në gjykim.

Në vlerësimin tim, këto rrethana do të përbënin mjaftueshëm një bazë të dhënash mbi të cilën mund të konkludohej se subjekti ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, edhe sikur të mos ekzistonin rrethanat që kanë bërë të mundur aplikimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, duke bërë të zbatueshëm në mënyrë autonome paragrafin 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, si një nga shkaqet e shkarkimit nga detyra të subjektit.

Për sa më sipër, problematikat e konstatuara në vlerësimin e kriterit të pasurisë, së bashku me mangësitë e konstatuara në vlerësimin e aftësive profesionale, duhej të ishin vlerësuar në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, duke e çuar trupin gjykues në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit, në përputhje me parashikimet e nenit 61, pika 5 e këtij ligji.

**Komisionere**  
**Genta TAFA (BUNGO)**